

Besjan Hysi

Ka lindur në Vlorë, më 2 qershor 1991 dhe në vitin 2013 është diplomuar “*Jurist*”. Z. Hysi ka nisur eksperiencën në sistemin gjyqësor gjatë vitit 2011 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në funksionin “*sekretar gjyqësor*” dhe më pas ka vijuar si asistent avokat në vitin 2017. Në vitin 2018 emërohet përkohësisht Avokat Shteti pranë Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Shtetit, ndërsa gjatë viteve 2019-2020 shërben si Avokat Shteti pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe më pas rikthehet në Zyrën e Inspektimit.

Prej datës 1.7.2022 z. Hysi mban detyrën e Drejtuesit të Zyrës së Inspektimit. Në vitin 2016 është diplomuar në Master Profesional në “*Të Drejtën Penale*”, dhe nga viti 2022 mban titullin Master i Shkencave në “*Të Drejtën Publike dhe Ndërkombëtare*”.

Z. Hysi është angazhuar vazhdimisht në pjesëmarrje në trajnime, tryeza dhe seminare me fokus të drejtën civile dhe administrative, përfshi edhe trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës.